



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 19.12.2025

MBLEDHJA Nr. 52,
Datë 23.12.2025, ora 09:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 23.12.2025, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 52 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi fillimin e procedurës për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.
6. Mbi planin e investimeve të shoqërisë OST sh.a. për periudhën rregullatore 2025 – 2027.
7. Mbi raportimin për sigurimin nga të licencuarit.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI